

VENDIM
Nr. 85, datë 19.3.2026

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ENER TRADE” SHPK PËR
KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË
ORIGINËS**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 863/1 prot., datë 18.3.2026, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Ener Trade’ sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës”, konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Ener Trade” sh.p.k.
 - Shoqëria “Ener Trade” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 226 datë 26.10.2018, i ndryshuar dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018, i ndryshuar.
 2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria
 - Shoqëria “Ener Trade” sh.p.k., me shkresën me nr. 863 prot. datë 10.3.2026, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në përputhje me nenin 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024.
 - Shoqëria ka përcjellë të plotësuar, duke specifikuar të dhënat identifikuese sipas kërkesave të nenit 6, pikës 4.1 të rregullores.
 3. Analiza ligjore dhe vlerësimi
 - Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.
 - Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjistër si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.
 2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Ener Trade” sh.p.k. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti